



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**KALENDARI I SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR**  
**PËR VITIN 2012**

Përgatitur nga: Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj,  
Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Europian

**Janar 2012**

Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) botohet çdo vit dhe përfshin të gjitha proceset dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e SPI-së. Komponentët kryesorë të SPI-së janë: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Integrimi European, Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Ndihma e Huaj.

## STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM [SKZHI]

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim është një dokument që shpreh aspiratat kombëtare, i artikulon këto në një sërë prioritetesh afatmesme dhe afatgjata dhe shërben si kuadri i referencës për alokimin e fondeve gjatë procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 (SKZHI) përfaqëson dokumentin strategjik themelor të vendit që harmonizon perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, integrimin në strukturat e Bashkimit Evropian, si dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Miratuar në mars të vitit 2008, SKZHI 2007-2013 përmbledh 21 strategji sektoriale dhe 17 strategji ndërsektoriale, procesi i hartimit të të cilave ka mbaruar dhe prej të cilave janë miratuar 29.

Në vijim të zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) dhe në mbështetje të funksionit të tij si departament i koordinimit të politikave dhe strategjive në nivel qendror, DEBASKON ka kryer procesin e vlerësimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI 2007-2013. Ky vlerësim konstaton domosdoshmërinë e rishikimit të SKZHI-së aktuale dhe të hartimit të **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020 (SKZHI 2007-2013)**. Kjo periudhë kohore përkon me periudhën e programimit financiar të ardhshëm të BE-së 2014-2020, me Strategjinë e Lisbonës së BE-së deri më 2020, si edhe me 2 cikle të programimit të PBA-së.

Nevoja e hartimit të SKZHI-së 2007-2013 buron nga fakti që SKZHI-ja përbën thelbin e Sistemit të Planifikimit të Integruar, si sintezë e të gjitha strategjive/politikave që udhëheqin programimin buxhetor afatmesëm. Këto strategji përfundojnë në masën më të madhe në vitin 2013.

- Dokumenti i SKZHI-së është kërkesë ligjore që buron nga Ligji i Menaxhimit të Buxhetit të Shtetit dhe shërben si bazë për orientimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).
- Objektivi afatgjatë për vendin është anëtarësimi në BE. SKZHI 2013-2020 do të jetë pikërisht dokumenti strategjik që do të përfshijë të gjitha reformat e nevojshme administrative për arritjen e këtij objekti.
- SKZHI 2013-2020 do të ishte një përgjigje shumë e mirë ndaj raportit të fundit të Komisionit European për përvijimin e reformave të ndërmarra nga administrata shqiptare, drejt integritit të plotë evropian të vendit.

### 1.a Fazat kryesore të hartimit të SKZHI-së 2013-2020

- Fillimi dhe lançimi i procesit për hartimin e SKZHI-së 2013-2020
- Përgatitja dhe konsultimi i drafteve të dokumentave strategjik sektorial/ ndërsektorial në kuadrin e SKZHI 2013-2020
- Finalizimi i SKZHI 2013-2020

**Faza I: Fillimi dhe lançimi i procesit për hartimin e SKZHI-së 2013-2020**

<b>Muaji</b>	<b>Data</b>	<b>Insitucioni përgjegjës</b>	<b>Veprimi</b>
Janar	3-31	Grupi i punës I. (DEBASKON me MF, MIE )	Miratimi i Urdhërit të Kryeministrit për:” Procesin e hartimit të SKZHI-së 2013-2020”
Janar	3-31	MF	Hartimi i kuadrit makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2013-2020
Janar – Shkurt		Grupi i Punës II. (MF me DEBASKON, MIE )	Lançimi i Procesit me ML
Shkurt	3-31	Grupi i Punës I. (DEBASKON me MF, MIE)	Miratimi në KPS i politikave prioritare për 2013-2015
Shkurt	1-29	MF	Përgatitja e tavaneve paraprake për PBA 2013-2015, si edhe për periudhën 2016-2020
Shkurt	1-29	Grupi i Punës I. ( MF me DEBASKON, MIE)	Përgatitja e Udhëzimit të për përgatitjen e Buxhetit me ndryshimet e nevojshme
Shkurt	1-29	ML	Përgatitja e planeve të punës për procesin e hartimit të dokumentit strategjik sektorial në kuadrin e SKZHI hartimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale
Shkurt	1-29	ML	Riaktivizimi ose ngritja, kur nuk egzistojnë, me urdhër ministri të Grupit Këshillimor, me përbërje anëtarë nga grupet e interesit dhe partnerët socialë, akademikë, shoqëri civile, etj.
Shkurt	1-29	ML DEBASKON	Përgatitja e urdhërave të Kryeministrit për ngritjen e grupeve ndërministrorë për hartimin e dokumentit strategjik ndërsektorial dhe strategjive ndërsektoriale
Shkurt	1-29	ML	Përgatitja dhe dërgimi pranë DEBASKON i draftit për situatën aktuale të sektorit si dhe raportet e

		MIE	monitorimit për vitin 2011
--	--	-----	----------------------------

**Faza II: Përgatitja dhe konsultimi i drafteve të strategjive sektoriale e ndërsektoriale, dhe SKZHI 2013-2020**

<b>Muaji</b>	<b>Data</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Veprimi</b>
Mars	1-31	ML	Rishikimi i Politikave të Programit për 2013-2020. Hartimi dhe miratimi i Deklaratave të Politikave të Programeve
Shkurt-Mars		MIE	Hartimi i kapitullit të Integritimit Europian për SKZHI 2013-2020
Prill	1-30	ML	Planifikimi i shpenzimeve të programeve buxhetore nga ML për 2013-2020, duke përfshirë edhe PKZMSA-në.
Prill	1-31	ML	Përgatitja e drafteve të para të dokumentave strategjik sektorial/ ndërsektorial
Maj		DEBASKON	Paraqitja në Komitetin e Planifikimit Strategjik të drafteve të para të dokumentave strategjik sektorial/ndërsektorial (situata aktuale, vizioni,qëllimet, objektivat, treguesit)
Maj	1-31	ML	Konsultimet me Grupet Këshillimore të Deklaratave të Politikës së Programeve për periudhën 2013-2020
Maj		MF, DEBASKON, MIE	Kryerja e analizave të kërkesave buxhetore dhe organizimi i seancave dëgjimore me ML
Qershor-Korrik	1-30	ML	Rishikimi i Deklaratave të Politikave të Programeve dhe dokumentave strategjik sektorial/ ndërsektor në kuadrin e SKZHI
Qershor	1-31	MF	Përgatitja dhe miratimi në KPS i kuadrit makroekonomik të rishikuar për 2013-2020, dokumentit të PBA, tavanëve të rishikuara për 2013-2015, si edhe tavanet e burimeve për 2016-2020.
Korrik		MF	Përgatitja dhe dërgimi tek ML i udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit. (deri në 2020).
Korrik-Gusht		ML	Përgatitja e Drafteve të dokumentave strategjik sektorial/ ndërsektorial të kostuara (korrik - gusht 2012)

**Faza III: Finalizimi i SKZHI 2013-2020**

<b>Muaji</b>	<b>Data</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Veprimi</b>
Shtator	1-30	MF, DEBASKON, MIE	Analiza dhe rishikimi i Deklaratave të Politikave të Programeve
Shtator	1-30	DEBASKON	Shqyrtimi i drafteve të dokumentave strategjik sektorial/ ndërsektoriale të kostuara
Tetor	1-31	MF	Përgatitja dhe miratimi në KPS i kuadrit makroekonomik të rishikuar për 2013-2020, dokumentit të PBA, tavanëve të rishikuara për 2013-2015, si edhe tavanet e burimeve për 2016-2020.
Tetor	1-31	MF	Hartimi i Kapitullit të SKZHI për burimet financiare dhe parashikimet makroekonomike, për draftin që miratohet në KPS dhe konsultohet
Shtator - Tetor		MIE	Finalizimi i kapitullit të Integritit Europian për SKZHI 2013-2020
Shtator	1-30	ML	Konsultimet me Grupet Këshillimore të drafteve të dokumentave strategjik sektorial/ndërsektorial të kostuara
Shtator-Tetor		ML	Rishikimi i drafteve të dokumentave strategjik sektorial/ ndërsektorial të kostuara,
Shtator - Tetor		DEBASKON	Përgatitja e draftit të parë të SKZHI-së.
Tetor	1-31	DEBASKON	Miratimi i draftit të kostuar të SKZHI në KPS
Nëntor	1-30	DEBASKON	Konsultimi i SKZHI 2013-2020 me grupet e interesit, partnerët socialë dhe grupet sektoriale të punës me donatorët.

Dhjetor 2012– Janar 2013		DEBASKON	Përpunimi i draftit të SKZHI 2013-2020 dhe reflektimi i komenteve
Janar 2013		MF	Finalizimi i draftit të SKZHI për burimet financiare sipas kuadrit të rishikuar makroekonomik
Shkurt 2013		KPS/KM	Miratimi i SKZHI-së në KPS dhe në Këshillin e Ministrave
Mars 2013		DEBASKON	Botimi i SKZHI- së
Shtator 2012- Mars 2013		ML	Përgatitja, konsultimi dhe finalizimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale

### 1.b Mekanizmi i monitorimit të SKZHI 2007-2013 dhe Strategjive sektoriale dhe Ndërsektoriale.

Instrumentet aktuale të monitorimit janë Raporti Vjetor i Progresit të SKZHI dhe Matricat e Vlerësimit të Rezultateve të zbatimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Prej vitit 2010 Miratimi i Procesit të Monitorimit të Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale e cila ka si produkt përgatitjen nga cdo ministri të Matricës së Vlerësimit të Rezultateve (MVR) zëvendëson Planet e Integruara të Ministrive (PIM). Këto instrumente, për nga formati i tyre, kanë shërbyer si instrument komunikimi dhe transparence, të cilat synojnë të jenë një mjet efektiv i analizës së brendshme mbi ecurinë në arritjen e objektivave të vendosura në strategjitë, SKZHI, në programin e qeverisë dhe në PBA.

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Maj-Qershor		DEBASKON ML	Seancat dëgjimore për të analizuar synimet e planifikuara të treguesve të performancës që përmbahen në deklaratën e politikës të PBA por që prezantohen duke përdorur tabelat e planifikimit të MVR.
Qershor	1-30	DEBASKON	Diskutimi i tabelave të MVR në KPS dhe lançimi i procesit të monitorimit
Nëntor- Dhjetor  Dhjetor		DEBASKON ML	Seancat dëgjimore për të analizuar raportet e monitorimit nga ministrinë e linjës vit pas viti, duke përdorur tabelat e monitorimit.
	1-31	DEBASKON	Konsolidim i raporteve të monitorimit dhe tabelat e monitorimit të MVR në atë tabelë të rezultateve të MVR dhe i paraqet ato në KPS për konsideratë dhe veprim.

## INTEGRIMI EVROPIAN

Integrimi Evropian është synimi madhor i Qeverisë Shqiptare e cila do të vazhdojë të mbetet e angazhuar plotësisht në zbatimin e axhendës së saj Evropiane, si një prioritet i politikës së jashtme, gjatë vitit 2012. Të gjitha përpjekjet e përqëndruara në kuadër të zbatimit të SPI-së do të vazhdojnë të prodhojnë rezultate pozitive të pasqyruara në një reflektim më të mirë të iniciativave për Integrim Evropian.

Datat e përcaktuara në kalendar mbi aktivitetet e lidhura me Integrimin Evropian në disa raste janë vetëm indikative. Ato do të saktësohen rast pas rasti, në varësi të kalendarit të shërbimeve të KE-së për çështjet përkatëse.

### Proceset dhe produktet kryesore që lidhen me Integrimin Evropian janë:

1. Zbatimi i MSA-së :
  - a. Vlerësimi i zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
  - b. Reflektimi i prioriteteve të planit të zbatimit të MSA-së në procesin buxhetor dhe të PBA-së
  - c. Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
  - d. Analiza e Dokumentit të Partneritetit Evropian dhe raportit vjetor për progresin
  - e. Forcimi i strukturave të përbashkëta BE – Shqipëri, të ngritura me hyrjen në fuqi të MSA-së
  
2. Instrumenti i Para-aderimit (IPA)
  - a. Finalizimi i programimit IPA 2012
  - b. Programimi i IPA 2013
  - c. **Menaxhimi i Decentralizuar i Instrumentit të Para-Aderimit (IPA)**
  - d. Programimi i Instrumentit të Investimit për Ballkanin Perëndimor (WBIF) për vitin 2012

### 1a. Kalendar i Përditësimit të PKZMSA 2012 – 2015, Faza e përditësimit

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
30 nëntor – 15 dhjetor 2011		GNP / GMS	Rishikimi i përgjegjësive institucionale dhe funksionale për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga MSA, Partneriteti Evropian 2008 dhe Raportit Analitik 2010 dhe Raporti i Progresit 2011
1 dhjetor 2011 – 20 janar 2012		GNP/ GMS	Identifikimi i iniciativave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese; Rivlerësimi dhe ripërcaktimi i kapaciteteve administrative të nevojshme; Rivlerësimi dhe ripërcaktimi i kostove financiare në përputhje me Buxhetin 2012 dhe PBA 2012 – 2014 Vendosja e informacionit mbi masat kombëtare në sistemin e raportimit on-line; Hartimi i pjesës narrative të PKZMSA 2012 – 2015; Rishikimi dhe vendosja në sistem e pjesës narrative.
20 janar 2012 – 5		MIE/ GNP/ GMS	Kontrolli i informacionit të masave kombëtare dhe pjesës narrative të PKZMSA

shkurt 2012			
5 shkurt 2012 – 15 shkurt 2012		MIE	Hartimi i projektvendimit të Këshillit të Ministrave
15 shkurt 2012 – 25 shkurt 2012		MIE	Verifikimi i informacionit/ Finalizimi i dokumentit
26 shkurt 2012		MIE	Dërgimi i projekt VKM për mendim tek ministritë e linjës dhe institucionet e tjera
10 mars 2012		MIE	Dërgimi i projekt VKM për miratim në Këshillin e Ministrave

### **1b. Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së**

Me qëllim që PKZMSA të bëhet një instrument për bashkërendimin e reformave kombëtare në rrugën drejt anëtarësimit në BE, dhe si bazë për planet vjetore të punës së Qeverisë, është shumë e rëndësishme që monitorimi dhe raportimi për zbatimin e masave të kryhet në mënyrë efektive dhe periodike. Dokumenti i ri i PKZMSA për periudhën 2012-2015 parashikon dy forma monitorimi dhe raportimi, si:

- Monitorimi i brendshëm që kryejnë institucionet shqiptare duke ndjekur procedurat e brendshme; dhe
- Monitorimi i jashtëm që kryejnë institucionet dypalëshe të BE-Shqipërisë/Komisionit Europian dhe Shteteve Anëtare të BE-së.

Për monitorimin e brendshëm, Grupet Ndërinstitucionale të Punës për kapitujt e acquis-së kanë rol kryesor në monitorimin e zbatimit të masave të PKZMSA-së, ndërkohë Ministria e Integritimit Europian do të bashkërendojë procesin e monitorimit të brendshëm. Këto grupe kanë detyrën që të kërkojnë nga institucionet përgjegjëse raporte mbi zbatimin e PKZMSA-së lidhur me kapitujt për të cilët ata janë përgjegjës. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare duhet të paraqesë në Kuvend raporte për zbatimin e PKZMSA-së.

Monitorimi i jashtëm do të ndiqet përmes Dialogut Politik dhe kuadrit institucional të përcaktuar në MSA, si një formë periodike dhe e stabilizuar e komunikimit të ndërsjellë mes Shqipërisë dhe BE-së. Gjithashtu, nëpërmjet misioneve të përfaqësuesve të BE-së për fusha të ndryshme, cilësia e harmonizimit të sistemit ligjor dhe shpejtësia e procesit do të vlerësohen në përputhje me planet e parashikuara në PKZMSA. Progres raportet vjetore të BE-së për Shqipërinë do të jenë gjithashtu një nga aspektet e mekanizmit për monitorimin e PKZMSA-së.

Për sa i përket instrumentave të monitorimit, risi e qënësishme do të jetë përdorimi i Sistemit elektronik të PKZMSA-së i cili do të ofrojë një përmbledhje të fazës ku kanë arritur autoritetet kompetente në realizimin e detyrimeve që kanë planifikuar. Një instrument tjetër që mbështet monitorimin e zbatimit të PKZMSA-së është Baza e të Dhënave e Përafrimit të Legjislacionit. Kjo bazë të dhënash do të shërbejë për të bashkuar regjistrin për legjislacionin kombëtar (që është planifikuar dhe miratuar), regjistrin për legjislacionin e BE-së, si dhe lidhjet mes masave kombëtare dhe masave të BE-së, dhe do të ofrojë tabelat përkatëse të harmonizimit. Raportet dhe karakteristikat e kësaj baze të dhënash për eksportimin e të



dhënave do të përdoren për të informuar Komisionin Evropian për përafrimin e legjislacionit dhe nivelin e statusit të harmonizimit.

### **2a. DSHIP dhe finalizimi i IPA 2012**

<b>Muaji</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Veprimi</b>
Janar-Dhjetor	ML	Fillon kontraktimi i projekteve nën IPA 2011
Shkurt	MIE	Përfundon dorëzimi në Delegacionin e BE-së projekt-fishat dhe fishat sektoriale për projektet që do të përfshihen në IPA 2012.
	Komisioni Evropian, MIE	Diskutohen në detaje projekt-fishat dhe Fishat Sektoriale e IPA 2012 me Misionin Programues të IPA 2012
Mars	Komisioni Evropian, ML, MIE	Reflektohen sugjerimet/komentet e fundit dhe rishikohen në detaje projekt-fishat
Maj-Qershor	Komisioni Evropian	Këshillim brenda Shërbimeve të Komisionit
Korrik - Shtator	Komisioni Evropian	Komiteti i IPA-s miraton fishat e IPA-s për vitin 2012
Nëntor	MIE	Miratohet Marrëveshja Financiare të IPA 2012

### **2b. Programimi i IPA 2013**

<b>Muaji</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Veprimi</b>
Maj/Qershor	MIE	Përgatit Kalendarin për Programimin e IPA 2013
Korrik	MIE, ML	Përgatisin analizën sektoriale dhe identifikimin e prioriteteve sipas PKZMSA-së të rishikuar, strategjive sektoriale dhe SKZHI, MIPD 2011-2013 dhe Progres Raporti Vjetor i BE-së.
Shtator	ML	Përgatisin projekt-propozimet për mbështetje nga IPA 2013
	MIE, DEBASKON ML	Përfundojnë konsultimet për projekt-propozimet e Ministrive të Linjës
Tetor	KPS	Miraton projekt idetë e IPA 2013
Nëntor	Komisioni Evropian, MEI / DEBASKON, ML	Misioni i programimit të IPA, negocohen projektet e miratuara
Dhjetor	ML	Shkrimi i projekt-fishave të IPA 2013

**2c. Menaxhimi i Decentralizuar i Instrumentit të Para-Aderimit (IPA)**

<b>Muaji</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Veprimi</b>
Janar	MF	IPA I - Punësimi i stafit të CFCU-së
Janar	MF	IPA I - Akreditimi Kombëtar
Shkurt	MF MIE	IPA I - Dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit pketën e akreditimit
Janar – Prill	MF MIE	Hartimi dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe proceseve përkatëse për menaxhimin e decentralizuar të komponentëve 2,3,4 të IPA-s.
Janar– Korrik	ML MF MIE	Plotësim i nevojave/boshllëqeve për menaxhimin e decentralizuar për IPA II, III, IV
Janar-Tetor	ML MF MIE	Vetë vlerësimi i institucioneve të Qeverisë mbi pajtushmërinë ndaj rregulores së menaxhimit të decentralizuar të IPA për komponentët 2,3,4
Korrik	Komisioni European	Vlerësimi i institucioneve të Qeverisë mbi pajtushmërinë ndaj rregulores së menaxhimit të decentralizuar të IPA për komponentët 2,3,4

**2d. Programimi i Instrumentit të Investimit për Ballkanin Perëndimor (WBIF) për vitin 2012**

<b>Muaji</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Veprimi</b>
Janar – Shkurt	ML	Përgatisin projekt-propozimet për mbështetje nga WBIF
	MIE,DEBASKON	Kryejnë konsultimet për projekt-propozimet e Ministrive të Linjës
	MF	
Shkurt	KPS	Miraton projekt idetë për raundin e VII-të të WBIF
Shkurt	MEI	Dërgon zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit propozimet dhe fishat e Shqipërisë
Qershor	Komiteti	Miraton listën e projekteve për mbështetje në raundin e VII-të

	Drejtues i WBIF	
Qershor – Korrik	ML	Përgatimin projekt-propozimet për mbështetje nga WBIF
Korrik	KPS	Miratoni projekt idetë për raundin e VII-të të WBIF
Korrik	MEI	Dërgon zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit propozimet dhe fishat e Shqipërisë
Dhjetor	Komiteti Drejtues i WBIF	Miratoni listën e projekteve për mbështetje në raundin e VII-të

## PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM [PBA]

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është elementi thelbësor i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Procesi i përgatitjes së PBA-së udhëhiqet nga Ministria e Financave dhe kërkon nga çdo ministri hartimin e një plani 3-vjeçar brenda një tavani të caktuar shpenzimesh për arritjen e objektivave politike në program si një hap i ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të SKZHI-së dhe strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.

- **Proceset dhe produktet kryesore të PBA-së:**

### 1. Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik

#### 2. Përditësimet ekonomike dhe financiare dhe Raportet

Muaji	Data	Veprimi
Mars		Vlerësimi Makroekonomik dhe Financiar për vitin 2011
Prill		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2012
Korrik		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2012
Tetor		Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2012
Nëntor		Raporti Vjetor Makroekonomik për Komisionin Evropian

### 3. Përgatitja e PBA-së për periudhën 2013-2015 dhe e Buxhetit të Shtetit 2013

#### a. Procesi i hartimit të PBA-së 2013-2015

i. Vlerësimi i prioriteteve: Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)

ii. Vlerësimi i prioriteteve: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)

#### b. Vlerësimi i prioriteteve: Buxheti vjetor

Shënim:

- Datat dhe veprimet që lidhen me PBA-në përmenden edhe në pjesë të tjera

### Kalendari për PBA-në dhe Buxhetin për vitin 2012

Periudha	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi përkatës
Janar	9	MF	Paraqet në KPS Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore
Janar	11	KPS/KM	Miraton Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B) . KM miraton R.V.P.M.B.
Janar	25	KM	Shqyrton dhe miraton Programin EFP
Shkurt	1	DEBASKON	Paraqet në KPS për diskutim dhe miratim Politikat Prioritare me ndikim në tavanet e përgatitjes së PBA
Shkurt	1	MF	Paraqet në KPS tavanet e përgatitjes së PBA
Shkurt	8	KPS/KM	KPS shqyrton tavanet e përgatitjes së PBA dhe i dërgon për miratim në KM. Tavanet e përgatitjes së PBA miratohen në KM.
Shkurt	15	KM	Paraqet për informacion R.V.P.M.B dhe Tavanet në Kuvend
Shkurt- 20 Prill	17	MF	Dërgon Udhezimin e Përgatitjes së Buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
17 Shkurt – 27 Prill	17 Shkurt - 27 Prill	Njësitë e Qeverisjes Qëndrore dhe Fondet Speciale të tyre	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore.
Prill	30	Njësitë e Qeverisjes Qëndrore dhe Fondet Speciale të tyre	Paraqesin në Ministri e Financave kërkesat e tyre buxhetore
Maj	1 - 18	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave buxhetore
Maj	21 - 31	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Qershor	5	MF	Dorezon për miratim në KPS parashikimin e perditësuar makro
Qershor	1-14	MF	Përgatit dokumentat e PBA-së dhe tavanet e reja të PBA-së.
Qershor	11	KPS/KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro ekonomik.
Qershor	18	MF	Paraqet dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së për shqyrtim dhe miratim në KPS.
Qershor	29	KPS/KM	Miraton dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së.
Korrik	9	MF	Dërgon Udhezimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Korrik	26	MF	I paraqet Kuvendit për informacion Vendimin e miratuar të dokumentit të PBA-së.
Korrik - Gusht	11 Korrik - 30 Gusht	Njësitë e Qeverisjes Qëndrore dhe Fondet Speciale të tyre	Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore .

Gusht	31	Njësitë e Qeverisjes Qëndrore dhe Fondet Speciale të tyre	Paraqesin në Ministrinë e Financave kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	3- 14	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	17- 28	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Tetor	5	MF	Paraqet në KM parashikimin e përditesuar makroekonomik.
Tetor	11	KPS/KM	Miraton parashikimin e përditesuar makroekonomik.
Tetor	19	MF	Përgatit dokumentin e rishikuar të PBA-së, Projektbuxhetin Vjetor dhe i paraqet për shqyrtim në KPS.
Tetor	24	KPS/KM	Miraton Projektbuxhetin Vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së.
Tetor	31	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin Vjetor dhe Dokumentin e Rishikuar të PBA-së.

## NDIHMJA E HUAJ

Një bashkërendim më i madh i ndihmës së huaj me përparësitë strategjike kombëtare dhe procesin e planifikimit të buxhetit është objektivi kryesor i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Efikasiteti i menaxhimit të ndihmës varet nga suksesi i disa proceseve monitoruese dhe mbarëvajtja e aktiviteteve koordinuese me donatorët.

### Proceset dhe produktet kryesore që lidhen me ndihmën e huaj

1. Monitorimi i ndihmës së huaj
2. Aktivitetet për koordinimin e donatorëve

### KALENDARI PËR NDIHMËN E HUAJ PËR VITIN 2012

#### 1. Monitorimi i Ndhmës së Huaj

Muaji	Data	Veprimi
Janar- Mars		Përditësimi dhe analizimi i të dhënave mbi projektet e donatorëve
Prill - Qershor		Përditësimi dhe analizimi i të dhënave mbi projektet e donatorëve
Qershor-Gusht		Përgatitja dhe botimi i Raportit të Progresit të Ndhmës së Huaj 2011

#### 2. Aktivitete për koordinimin e donatorëve

Muaji	Data	Veprimi
Janar		Takimi i grupit mbështetës të SPI-së
		Hartimi i kalendarit të misioneve programuese dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorët
		Hartimi i kalendarit të takimeve të Grupeve Sektoriale të Punës 2011-2012 <sup>1</sup>
Shkurt		Takimi i Sekretariatit Teknik të Donatorëve. Takim i Grupit të Partnerëve për Integrimin dhe Zhvillimin

<sup>1</sup> Bashkangjitur si shtojcë 2

Shkurt		Takim me Pikat e Kontaktit të Grupeve Sektoriale të Punës.
Prill		Takim i Grupit të Partnerëve për Integrimin dhe Zhvillimin
Maj		Takimi i grupit mbështetës të SPI-së
Qershor		Takimi i Sekretariatit Teknik të Donatorëve.
Shtator		Takimi i grupit mbështetës të SPI-së Takim i Grupit të Partnerëve për Integrimin dhe Zhvillimin
Tetor		Takimi i Sekretariatit Teknik të Donatorëve.
Nëntor		Tryeza e rrumbullakët Qeveri - Donatorë

#### KALENDARI PARAPRAK I TAKIMEVE TË KPS PËR VITIN 2012

**Synimi kryesor i hartimit të kalendarit të SPI-së është pikërisht hartimi i axhendës paraprake të takimeve të KPS-së, organ i cili miraton proceset kryesore të SPI-së. Kalendarit i mëposhtëm është hartuar duke harmonizuar datat e sejcilit proces.**

Muaji	Data	Aktiviteti
Janar	16	KPS/KM Miraton Raportin mbi Vleresimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B) . KM miraton R.V.P.M.B.
Shkurt	8	KPS/KM Shqyrtimi në KPS i Dokumentit mbi Politikat Prioritare që ndikojnë në caktimin e tavaneve Miratimi në KPS i tavaneve të ministrive për PBA 2013-2015.
Maj	1-31	KPS KPS shqyrton draftin fillestar të SKZHI-së ku përfshihet vizioni, qëllimi, objektivat dhe treguesit e saj.
Qershor	11	KPS Miraton parashikimin e përditesuar makroekonomik.
Qershor	29	KPS/KM Miraton dokumentin e PBA-së 2013-2015 dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së 2013-2015.
Tetor	15	KPS/KM Miraton parashikimin e përditesuar makroekonomik. Shqyrton dhe miraton draftin e konsoliduar të SKZHI-së 2013-2020.
Tetor	24	KPS/KM Miraton Projektbuxhetin Vjetor 2013 dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së 2013-2015.

			Miratton projekt idetë e IPA 2013
Dhjetor	21	KPS/KM	Shqyrton dhe miratton Kalendarin e MSHP.



## BOTIME NË KUADËR TË SPI-së PËR VITIN 2012

Në kuadër të zbatimit të SPI-së dalin në shtyp disa botime që jepen në tabelën më poshtë:

Muaji	Institucioni përgjegjës	Botimi
Shkurt	DEBASKON	Kalendari i SPI-së
Qershor-Gusht	DEBASKON	Raporti i Ndihmës së Huaj 2011
Çdo muaj	DEBASKON dhe DTS	Botimi informativ i përmuajshëm i "Government-Donor Dialogue"
Shkurt	DEBASKON	Plani i Komunikimit të SPI-së
Tetor	MF	Botimi i projektbuxhetit

## Shtojca 1

### Vështrim i përgjithshëm mbi proceset.

#### 1) Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2013-2020

Metodologjia për procesin e hartimit të SKZHI 2013-2020 bazohet në parimin e funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me Sistemin e Planifikimit të Integruar SPI. SKZHI 2013-2020 mbështetet veçanërisht në harmonizimin sa më të mirë me ciklin e Programimit Buxhetor Afatmesëm dhe me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA. Në veçanti, SKZHI 2013-2020 kërkon:

- **Lidhjen e plotë midis PBA me PKZMSA**, ku aktivitetet, masat dhe angazhimet në kuadër të MSA janë pjesë integrale e PBA dhe e SKZHI. Në këtë mënyrë përcaktohet deri në detaje kostoja e integritit evropian dhe angazhimeve në këtë kuadër.
- **Harmonizimin më të mirë të PBA me SKZHI** përmes:
  - hartimit të një kuadri makroekonomik për 2013-2020, që përfshin prioritetet e politikave për 2013-2020, financimin e huaj të parashikuar apo programuar, si edhe aspekte të tjera lidhur me financimin dhe të ardhurat.
  - objektivat e politikave të mirëpërcaktuara për 2013-2020, të cilat përfshijnë edhe objektivat në kuadër të integritit evropian. Për këtë qëllim, Udhëzimi për përgatitjen e Buxhetit përcakton detajet teknike të përfshirjes së objektivave për 2013-2020 në PBA e ardhshme.
- **Harmonizim të kuadrit institucional/strukturave të SPI me strukturat e IE.** Kjo nënkupton: (i) informim të KPS për procese që diskutohen në KNIE; (ii) përfshirje të drejtorive të integritit në Grupet për Menaxhim Strategjik; (iii) komunikim më të mirë të Grupeve Institucionale të Punës për çështje të Integritit Evropian me Grupet për Menaxhim Strategjik të ministrive të linjës.

#### *I. Politikat prioritare*

Në fillim të vitit 2012 do të fillojë procesi për Identifikimin dhe analizën e politikave prioritare për periudhën 2013-2015, me ndikim në tavanet e PBA-së, të cilat do të merren parasysh gjatë hartimit të kuadrit makroekonomik 2013-2020. DEBASKON luan një rol shumë të rëndësishëm, duke siguruar që prioritetet e politikave të shprehura në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, të reflektohen në përcaktimin e tavaneve buxhetore gjatë procesit të PBA-së 2013-2015.

- a. Dokumenti i Politikave Prioritare, për t'u përfshirë në PBA 2013- 2015
- DEBASKON do të hartojë Dokumentin e Politikave Prioritare me qëllim që të ndihmojë Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS) në përcaktimin e tavaneve buxhetore të ministrive dhe dhënien e informacionit për projekte të mundshme dhe për nevoja financiare për PBA 2013-2015. Ky dokument do të bazohet në propozimet e ardhura nga ministrinë dhe do të analizohet nga DEBASKON. Për të ndihmuar ministrinë e linjës janë shpërndarë udhëzime të

përgatitura për përcaktimin e politikave të reja apo ekzistuese, që kanë një vlerë të konsiderueshme financiare. Propozimet e ministrive do të paraqiten për diskutim dhe miratim në KPS në muajin janar 2012. Aty do të vendoset për prioritetet që do të merren parasysh në përcaktimin e tavaneve të PBA 2013-2015, të cilët do të miratohen më pas në mbledhjen e KPS-së në muajin qershor 2012.

## *II. Monitorimi i Strategjive Sektoriale dhe Ndërsektoriale*

Për të përmirësuar monitorimin e politikave dhe strategjive që po zbatohen nga Qeveria Shqiptare, është iniciuar nën koordinimin qëndror të DEBASKON, Mekanizmi i Monitorimit të Bazuar mbi Rezultatet që ka disa qëllime si:

- Të përmirësojë sistemin aktual të monitorimit – duke realizuar një raportim realist që identifikon dobësitë dhe problematikat.
- Të ndihmojë ministrinë e linjës për analizat sektoriale në lidhje me politikën e programit – ministrinë do të përmirësojnë zbatimin e strategjive sektoriale pasi të kenë rishikuar politikën e programeve,
- Të mbështesë planifikimin kombëtar dhe buxhetimin e performancës – si pjesë përbërëse e Sistemit të Planifikimit të Integruar(SPI).
- Të nxisë përgjegjshmërinë dhe transparencën – KPS analizon nivelin në të cilën ministrinë kanë arritur të përmbushin objektivat e politikave
- Shërben si bazë për rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020

Në këtë kuadër çdo ministri duhet të përgatisë Matricën e Vlerësimit të Rezultateve (MVR) si instrumenti kryesor i monitorimit të Strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar. MVR përfshijnë tabelat e planifikimit dhe tabelat e monitorimit të cilat përmbajnë tregues dhe qëllime të përcaktuara në nivelin e objektivave të strategjive dhe të programeve buxhetore afatmesme të ministrive. Një veçori thelbësore është që treguesit duhet të jenë të posaçëm, të matshëm, të arritshëm, realist dhe përcaktuar për një periudhë kohore të caktuar (SMART). Tabelat e planifikimit përcaktojnë veprimet dhe masat e planifikuara nga Ministrinë përkatëse për arritjen e objektivave të paracaktuar, ndërsa tabelat e monitorimit përshkruajnë veprimet dhe masat e ndërrmara me qëllim përcaktimin e rezultateve sipas programeve dhe strategjive.

## **2) Integrimi Evropian**

### **a. Rishikimi dhe përditësimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2012-2015**

Çdo vend kandidat që aspiron të bëhet anëtar i BE-së, është i detyruar që të përgatitë një plan kombëtar për miratimin e acquis së BE-së. Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA-së është konceptuar si një dokument i konsoliduar që përfshin të gjitha masat për zbatimin e MSA-së dhe masat për miratimin e acquis. PKZMSA-ja për periudhën 2012-2015 fokusohet te kapitujt e acquis, që njihen ndryshe si kapitujt e negociatave dhe te roli i grupeve ndërinstitucionale të punës. Përgjegjësia për përgatitjen dhe rishikimin periodik të PKZMSA është e grupeve ndërinstitucionale të punës, ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore publike.

PKZMSA 2012-2015 do të jetë i ndryshëm në një sërë aspektesh dhe do të përmirësojë versionin e mëparshëm si:

- do të përcaktohen në mënyrë të hollësishme të gjithë detyrat e ardhshme për harmonizimin e legjislacionit (“masat kombëtare të planifikuara”), përfshi një afat të qartë për zbatimin e tyre deri në fund të vitit 2015, duke krijuar kështu bazën e agjendës ligjore të Qeverisë (dhe të Kuvendit);
- do të jepet një tablo e qartë e kapaciteteve administrative dhe institucionale të nevojshme për zbatimin e legjislacionit të përafshur;
- do të jepet një tablo e qartë e efekteve financiare të transpozimit të legjislacionit të BE-së dhe të përcaktohen kostot për forcim kapacitetesh dhe shpenzimesh për të gjithë kapitujt e acquis;
- do të jetë në përputhje me dispozitat e Programit Buxhetor Afatmesëm, duke garantuar kështu që çdo masë të ketë financim të plotë nga buxheti i shtetit dhe/ose asistencë e huaj;
- do të jepet një tablo e qartë e asistencës që BE-ja apo donatorë të tjerë u japin institucioneve shqiptare.

PKZMSA i ri duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe të konsiderohet pjesë përbërëse e saj. PKZMSA duhet të jetë në përputhje edhe me strategjitë sektoriale të SKZHI-së, duke funksionuar kështu si program strategjik për integrimin.

Ministria e Integritimit do të udhëheqë procesin e përgatitjes dhe koordinimit të procesit të hartimit, raportimit dhe monitorimit të PKZMSA-së, ndërkohë që grupet ndërinstitucionale të punës do të bashkërendojnë aktivitetet e ministrive dhe institucioneve kontribuuese për çdo kapitull të acquis.

Në ministritë e linjës, hartimi i PKZMSA-së do të jetë përgjegjësi e Grupeve të Menaxhimit Strategjik (GMS) të krijuara në kuadrin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). GMS-të do të marrin detyra nga grupet ndërinstitucionale të punës dhe do të asistojnë ato në procesin e hartimit, monitorimit dhe raportimit të PKZMSA-së.

#### **b. Programimi i IPA-s për vitin 2012 dhe fillimi i programit të IPA 2013**

Procesi i planifikimit për IPA 2012 ka filluar në muajin maj 2011, brenda muajit janar 2012 paketa e projekt fishave për IPA 2012 do të jetë përgatitur nga institucionet shqiptare. Kjo paketë do të konsultohet në vijim me shërbimet e Delegacionit të BE-së në Tiranë, për komente dhe sugjerimet e fundit me qëllim përmirësimin dhe konsolidimin e dokumenteve. Më tej, paketa finale do t’i përcillet për miratim Komisionit Evropian në Bruksel sipas procedurave përkatëse për të mbyllur procesin me nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare.

#### **c. Programimi i Instrumentit të Përgatitjes së Projekteve të Investimit në Infrastrukturë (IPF) për vitin 2010**

Në mbështetje të programit IPA kombëtare, instrumenti financiar i Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) me aktorë kryesorë KE, BEI, BERZH, KfW dhe CEB, krijon burime financimi të përbashkëta me kontribut të Komisionit Evropian, partnerëve ndërkombëtarë financiarë, shteteve anëtare dhe donatorë të tjerë. Gjatë muajit janar 2012, Ministritë e Linjës do të përgatisin propozime me qëllim financimin e projekteve prioritare në sektorët e transportit, energjisë, mjedisit, sektorët socialë, SME-të, eficienta e energjisë, sektori financiar. Pas konsultimeve të brendshme dhe miratimit të paketës për t’u përcjellë në raundin e VII nga KPS, Ministria e Integritimit në cilësinë e NIPAC do t’i përcjellë pranë Komisionit Evropian në shkurt 2012. Autoriteti që do të përzgjedhë dhe miratojë projektet e Raundit të VII-t është Komiteti Drejtues i WBIF dhe kjo do të bëhet gjatë muajit qershor 2012. Gjithashtu, në qershor 2012 Ministritë e Linjës pritet të fillojnë përgatitjen e projekt-propozimeve për raundin e VIII-të të WBIF. Pas miratimit të paketës së WBIF

raundi i VIII-të në KPS, NIPAC përcjell zyrtarisht listën e projekt propozimeve në fund të muajit korrik 2010, me qëllim miratimin në vijimësi gjatë muajit dhjetor 2012 nga Komiteti Drejtues i WBIF.

### **3) Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA)**

Qëllimi i PBA-së është të sigurohet një lidhje e qartë mes shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave politike në program, duke arritur parashikueshmëri dhe efikasitet më të lartë në shpërndarjen e burimeve. Hartimi i këtij dokumenti kalon nëpër etapat e mëposhtme:

#### **1. Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik**

Analiza dhe parashikimi makroekonomik për periudhën 2013-2015 përgatitet në fillim të vitit me qëllim që të ofrohet informacioni për përcaktimin e përparësive strategjike, shpenzimeve agregate, synimeve në lidhje me të ardhurat dhe defiçitin, si dhe tavanëve për përgatitjen e PBA-së në nivel ministrie. Parashikimi fillestar përgatitet gjatë muajit dhjetor dhe finalizohet në fillim të muajit janar. Vlerësimi dhe parashikimi përditësohen në dy momente kyç gjatë vitit: në muajin prill, përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavanëve të PBA-së për shpenzimet, dhe në muajin gusht, përpara se të dërgohet në Parlament projektbuxheti i shtetit.

#### **2. Përditësimet Ekonomike dhe Financiare dhe Raportet**

Çdo tre muaj do të botohen përditësimet përsa i përket ecuresë ekonomike dhe financiare të vendit. Përveç kësaj, vlerësimi i fundvitit do të mbarojë përpara fundit të tremujorit të parë. Një raport vjetor i paraqitet Komisionit Evropian përpara fundit të muajit nëntor.

#### **3. Përgatitja e PBA-së për periudhën 2013-2015 dhe e Buxhetit të Shtetit 2013**

PBA-ja e parë që përfshinte të gjitha ministrinë u realizua si proces në vitin 2006. Fazat kyçe të PBA-së 2013-2015 miratuar me VKM nr 147, date 02.03.2011, që do të zhvillohen në vitin 2012, janë si më poshtë:

##### *a. Vlerësimi i prioriteteve: Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)*

Në kuadrin e procesit të PBA-së, çdo ministri përgatit deklaratat për politikat e programeve të saj buxhetore, të cilat shqyrtohen dhe rishikohen brenda ministrisë. Ky rishikim kryhet gjatë muajit mars, pas caktimit të tavanëve për çdo ministri linje, në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2013-2015. Rishikimi i politikave të programeve përcakton shpenzimet e detajuara për secilin program si dhe projektet e investimeve, dhe bën të mundur që ministrinë të hartojnë buxhetet indikative të programeve. DEBASKON në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritit do të bashkërendojë procesin e RPP-së. Qëllimi i RPP-ve është që synimet dhe objektivat e shprehura në SKZHI, në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe në MSA të reflektohen sa më mirë në kërkesat për shpenzime të ministrive të shprehura në PBA.

##### *i. Vlerësimi i prioriteteve: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)*

Gjatë periudhës maj – qershor, ministrinë e linjës paraqesin në Ministrinë e Financave, në kuadrin e PBA-së, Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP). Këto parashikime rishikohen më pas nga Ministria e Financave, DEBASKON dhe Ministria e Integritit European, dhe prezantohen për diskutim në negociatat që zhvillohen me ministrinë e linjës. DEBASKON dhe Ministria e Integritit do të jenë pjesë e këtyre negociatave dhe do të fokusohen në realizimin e objektivave të strategjive sektoriale dhe angazhimeve të MSA-së, nëpërmjet procesit të PSHIP-it. Mbi bazën e këtyre negociatave të

zhvilluara, Ministria e Financave përgatit një draft të PBA-së 2012-2015, të cilin e paraqet për diskutim dhe miratim në KPS.

*ii. Vlerësimi i prioriteteve: buxheti vjetor 2013*

Nëse ka ndryshime të konsiderueshme, DEBASKON do të bëjë një vlerësim për të matur impaktin e këtyre ndryshimeve në zbatimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.

Gjatë muajit qershor, KM do të shqyrtojë dhe miratojë draftin e parë të PBA-së dhe tavanet e PBA-së për shpenzimet. Gjatë muajit tetor do të shqyrtohet dhe miratohet drafti i dytë i PBA-së si dhe projektbuxheti vjetor.

## SHTOJCA 2: KALENDARI I TAKIMEVE TË GSP

Kalendari i Takimeve të Grupeve Sektoriale të Punës (GSP)

I ripare ne Janar 2011

Legjenda: Takimet e Kryera Të planifikuara

No.	Ndarcja e Prioriteteve Strategjike (Bazuar në SKZHI)	Grupet Sektoriale të Punës (GSP)	2011												2012													
			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor		
1	Infrastruktura	Energji																										
		Transport																										
		Uji					03/05	09/06 &																				
		Mjedisi																										Jv2
2	Ekonomia dhe Financat	Ekonomia (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme & Sektori Privat Teknologjia e Çitësië dhe Tregu i Brendshëm)						06/06																				
		Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi																										Jv4
		Statistika		14/02																								Jv1
		Financat Publike	IPS SG 25/01																									Jv4
		Prokurimi Publik	27/01																									Jv1
3	Zhvillimi Shoqëror	Sigurimet Shoqërore																									Jv2	
		Mbrojtja dhe Përfshirja Sociale																										Jv1
		Punësimi, dhe Formimi Profesional			24/03					01/07		16/09																07/12
		Barazia Gjinore dhe Dhama në Familje				01/04																						12/12
		Kultura dhe Rinia																										Jv1
		Arsimi (jo i përfshirë formimi profesional)						18/05		01/07		02/09																Jv1
		Shëndetësia																										Jv2
4	Drejësia dhe Çështjet e Brendshme	Drejësia: Reforma Ligjore (përfshirë: Drejtësia e të Miturve & Reforma e Burjeve)						18/05	10/06 JJ																		Jv3	
		Mbrojtja e Dëshmitarëve																										Jv3
		Policia e Shtetit (Policia dhe Krimi i Organizuar)									27/06																	Jv2
		Konsorciumi Ndërkombëtar																										Jv1
		Menaxhimi i Integruar i Kufijve dhe Migracionit		23/02																								Jv1
		Policia në Komitetet dhe Parandalimi i Krimin																										Jv2
		Trajtimi dhe Asistencë me bazë materiale									18/07																	Jv3
5	Zhvillimi Urban, Rural dhe Rajonal	Menaxhimi i Informacionit dhe Teknologjia		15/02																							Jv2	
		E Drejta e Pronës																										Jv4
		Anti Korrupsioni																										Jv4
		Parlamenti, Zgjidhjet dhe Regjistri Civil																										Jv3
		Administrata Publike		10/02							01/07 Konfere ncv																	Jv2
5	Zhvillimi Urban, Rural dhe Rajonal	Media dhe Shoqëria Civile																									Jv3	
		Decentralizimi dhe Zhvillimi Rajonal																									Jv1	
		Bujqësia, Ushqimi dhe Zhvillimi Rural		22/02																								Jv2
		Turizmi			04/03																							Jv1
5	Zhvillimi Urban, Rural dhe Rajonal	Planifikimi i Territorit dhe Strehimi																									Jv1	